


RELACION TEKNIK

OBJEKTI: “Stacion elektropompimi Bual Permet ”

BUAL - PERMET

PUNOI:

Ing. Fotaq Thodhori


FOTAQ THODHORI
NR LIC E 112/2

1 Furnizimi dhe shperndarja e energjise elektrike.

Furnizimi me energji elektrike eshte parashikuar te behet nga rrjeti Elektrik Ekzistues 10 kv Objekti eshte cilesuar si: “Stacion elektropompimi”.

1.1 Matja e energjise

Per matjen e energjise duhet te plotesohen te gjitha rregullat ne fuqi nga operatori i shperndarjes. Fuqia e kerkuar e objektit eshte 30 kW. Matja do te behet ne panelin kryesor me matje direkte. Paneli matjes do te instalohet ne kufi te pronesise se objektit.

Automatet qe do te vendosen brenda ne panelin kryesor do te jene me fuqi te ndryshme sipas pajisjeve dhe linjave qe do te mbrohen (Skema e Panelit Kryesor). Matesi do te furnizohet nga Operatori i Shperndarjes pas miratimit te pikes se lidhjes me kabell CU 4 x 35 mm².

1.2 Tokezimi

Tokezimi do te realizhet duke perdorur 8 elektroda hekuri "L" 50x50x5 mm 1.5m.

Bashkimi i tyre do te behet me percjelles bakri te zhveshur 35mm² qe lidhet me anen e kapikordave.

Elektrodat do te vendosen ne nje distance nga nj-tj 2m.

Tokezimi i neutrit ne kabine duhet te realizohet me vlera rezistence te tokezimit sipas normave (per tensionin e lejuar te prekjes se mases se paisjeve).

Pervec te gjitha pjeseve nen tension duhet gjithashtu te tokezohen te gjitha pajisjet metalike .


1.3 Tipi i percjellsave, ngjyrat dhe tubat mbrojtes

Per shperndarjen e energjise elektrike per furnizimin e paneleve eshte parashikuar te perdoren kablo shume polar, me clirim te paket te tymrave dhe gazeve toksike; me izolim gome G7 dhe me mbulesa te jashtme PVC ne rastin e kabllove. Temperatura maksimale e punimit te izolimit duhet te jete 90 grade.

Per furnizimin e makinerive te “ POMPE PER VADITJE” eshte parashikuar te perdoren percjellsa me izolim gome te cilesise G7 me temperatur maksimale funksionimi 90 grade.

Per furnizimin e stacionit te pompimit do te ndertohet nje kabine elektrike me dy shtylla centrifugale 10 ml sipas projektit .Transformatori I kabine s 10/0.4 kv ,100 kva do te jete per perdorim te jashtem me vaj .
Te gjitha pajisjet qe do te vendosen ne object duhet te jene brenda standarteve te kerkuara dhe te lyera me boje .

Ing Fotaq Thodhori


FOTAQ THODHORI
NR LIC E 112/2